



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/34

Datë: 05.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë në konsideratë Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Teknik 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet se parcela me 39.25 hektarë tokë, në shfrytëzim të kontingjentit të KFOR-it gjerman, e regjistruar në emër të Republikës së Kosovës në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 06/134 të datës 01.03.2017 dhe e evidentuar në bazë të certifikatës me numër të Njesisë Kadastrale P-71813068-05290-0 të datës 28.07.2017, pas tërheqjes së ushtarëve gjermanë të KFOR-it nga Baza Ushtarake në Prizren në fund të vitit 2018, prej datës 01.01.2019 do të vëhet në shfrytëzim për qëllime publike.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarr veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, që tokën nga pika 1. e këtij vendimi, prej datës 01.01.2019 ta shfrytëzojë për themelimin e një parku inovativ dhe trajnues gjermano-kosovar për një kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik dhe shkencor të Kosovës. Kryeministri në bashkëpunim me Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Republikës Federale të Gjermanisë do të përcaktoj mënyrën e organizimit të Parkut.
3. Për të zbatuar këtë vendim, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, themelon menjëherë një Komitet Drejtues të përkohshëm, nën përgjegjësinë e Zyrës së Kryeministrit, për përgatitjen e procesit të transformimit të tokës që shfrytëzohet nga kontingjenti i KFOR-it gjerman në një park inovativ dhe trajnues. Në vitin 2018, Komiteti Drejtues do të përcaktojë, ndër të tjera, objektivat e parkut dhe kriteret për përzgjedhjen e përdoruesit e ardhshëm dhe, në pritje të themelimit të një Komiteti të përhershëm drejtues, mbikëqyr zbatimin e transformimit në përputhje me kornizën aktuale ligjore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019.
4. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/34


Datë: 05.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 1,000,000 euro për KOSTT-in, për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave veriore të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Ministrinë e Financave nënprogramin Thesari me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete nga Thesari transferohen në llogarinë bankare të përcaktuar nga KOSTT.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë